



Prishtinë, 26 dhjetor 2019  
Kodi i ZRRE-së: V\_1212\_2019

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji**

**Duke u bazuar në:**

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, Nenin 25, Nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe Nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 25 të Rregullës Nr. 11/2017 për Procedurën e Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja bazuar në Burimet e Ripërtritshme të Energjisë;
- Nenin 18, 19 dhe 20 të Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e BRE-ve,dhe
- Aplikacionin për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë - konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në kulmin e objektin të Fabrikës për prodhimin e qumështit "Drena" SH.P.K., me kapacitet të instaluar prej 75 kW në Komunën e Skenderajt, të datës 06.12.2019 me nr. prot. 649/2019 të aplikuesit "Drena" SH.P.K., me adresë: rruga "Dëshmorët e Kombit" pn, Komuna e Skenderajt, Republika e Kosovës.

në seancën e mbajtur më 26 dhjetorit 2019 nxori këtë:

**V E N D I M**

**PËR NDËRTIMIN E KAPACITETEVE GJENERUESE PËR VETË-KONSUM**

- I. **APROVOHET** - kërkesa e aplikuesit "Drena" SH.P.K., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në kulmin e objektit të Fabrikës për prodhimin e qumështit "Drena" SH.P.K., me kapacitet të instaluar prej 75 kW, në Komunën e Skenderajt.
- II. **OBLIGOHET** – aplikuesi "Drena" SH.P.K., me shifër të regjistruar të njehsorit elektrik DMI- 9049098 që pas ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë-konsum, të parashtroj kërkesë në KEDS SH.A., për pranim teknik të objektit energjetik.
- III. ZRRE do të konsideroj projektin e finalizuar nga data e pranimit teknik sipas Pëlqimit Elektroenergjetik të lëshuar nga KEDS SH.A.
- IV. Aplikuesi "Drena" SH.P.K., do të lidh Marrëveshje për vetë-prodhim me furnizuesin me të cilën ka kontratë për furnizim me energji elektrike, pas konfirmimit të pranimit teknik nga KEDS SH.A., në pajtim me Nenin 18 paragrafi 1 dhe 2 i Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse.


**Arsyetim**



- o ZRRE, me datë 06.12.2019 nga aplikuesi "Drena" SH.P.K., ka pranuar aplikacionin për marrjen e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në kulimin e objektit të fabrikës për prodhimin e qumështit "Drena" SH.P.K., me kapacitet të instaluar prej 75 kW shifra e konsumatorit DMI- 9049098 që do të vendosen mbi objekt, në Komunën e Skenderajt.
  - o Aplikuesi, s'bashku me aplikacionin ka bashkangjitur edhe dëshminë nga KEDS për konsumin vjetor të energjisë elektrike, vlerësimin për prodhimin vjetor në kW/h të pajisjeve të instaluara, pëlqimin elektroenergetik Nr. 9048 të datës 26.11.2019 të lëshuar nga KEDS SH.A., dhe Pëlqimin 06-350/02-0069840/19 të datës 02.12.2019 të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit, Komunës së Skenderajt.
  - o Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës së aplikuesit "Drena" SH.P.K., dhe dëshmime të bashkangjitura, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë - konsum nga panelet solare/fotovoltaike në kulimin e objektit të fabrikës për prodhimin e qumështit "Drena" SH.P.K., me kapacitet të instaluar prej 75 kW, në Komunën e Skenderajt, ka vlerësuar ato, dhe ka konsideruar se janë plotësuar të gjitha dëshmitë relevante për lëshimin e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për vetë-konsum, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.
- V. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

  
Arsim Janova, u.d. Kryesues

  
Besim Sejfiqaj, Anëtar

  
Izet Rushiti, Anëtar

  
Selman Hoti, Anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- Palës,
- Komunës së Skenderajt,
- KEDS SH.A., dhe
- Arkivit të ZRRE-së.